



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K të datës 08.09.2023 kundër njoftimit mbi kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës - Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albi Company” Sh.P.K të datës 08.09.2023 kundër njoftimit mbi kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës-Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Albi Company” Sh.P.K si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Albi Company” Sh.P.K (tutje “parashtruesi”) me datë 08.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi kontratë të datës 31.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull, “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës-Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: Parashtruesi ka pretenduar që ka kërkuar të ofrohet projekti për aktivitetin e prokurimit tek zyra e njësisë për Departamentin e sportit, të cilët i janë përgjigjur se do të e informojnë parashtruesin në një datë më të vonshme. Parashtruesi është njoftuar përmes email dhe E-prokurim-it se nuk posedojnë në aktivitet të tillë por posedojnë vetëm një skicë që është situacion i gjerë ku paraqitet projekti, si dhe kanë informuar parashtruesin se nuk posedojnë projekt por vetëm paramasën dhe parallogarinë. Parashtruesi pretendon se skica në fjalë e ngarkuar në Ak në E-prokurim nuk përmbush kushtet si projekt mbasi që është situacion i gjerë si foto dhe asgjë më shumë. Parashtruesi pretendon që paraqitja e pozicioneve dhe parallogaritjeve para projektit është kundër standardeve. Ndër të tjera parashtruesi pretendon që procesi nuk ka qenë transparent dhe dikriminues. Parashtruesi si arsye kryesore për anulimin e tenderit e konsideron kohën e mangët e llogaritjes për analizimin e projektit dhe dhe sasisht e nevojshme.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 10 dhe 29 të LPP si dhe nenin 19 të RRPP.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 14.09.2023ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëj vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë (14.09.2023) njësi kërkuese ka kthyer përgjigjen si në vijim: "Nuk kemi projekt te detajuar per kete aktivitet te prokurimit vetëm nje skice te cilën e kemi bashkangjitur në dosje te tenderit ne eprokurim".

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të njësisë kërkuese pasi që sqarimet e tilla janë të plota, të bazuara në LPP dhe RRPP, të mbështetura në dëshmitë dhe dokumentet relevante të aktivitetit të prokurimit.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.